

## 2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit

Burimi i informacionit: PPV/PZhS; të tjera

- Është e rëndësishme ndërlidhja më e mirë e Bashkisë Shkodër në nivel rajonal duke shfrytëzuar transportin rrugor, hekurudhor dhe ujor.
- Përmirësimi i aksesit në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë.
- Promovimi i rigjenerimit të ish-zonave industriale si dhe ndërlidhja më e mirë e kësaj zonë me dy akse prioritare ekonomike Shkodër-Lezhë dhe Shkodër-Koplik, duke krijuar vazhdimësi dhe duke forcuar rolin e zonës ekonomike si pjesë e rajonit ekonomik Shkodër-Lezhë dhe rajonit ndërkufitar Podgoricë-Shkodër nga direktivat e PPK dhe PINS Bregdeti.
- Menaxhimi sa më të mirë i mbetjeve. Bashkia Shkodër do të promovojë riciklimin e mbetjeve urbane dhe ndarjen e mbetjeve që në burim, duke krijuar kosha të diferencuar.
- Zhvillimi ekonomik me theks në mjedis mjedisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore të Shkodrës. Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoaria), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit, ekonomia blu dhe ajo e gjelbër.
- Kujdes i veçantë duhet të tregohet për integrimin e brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.
- Integrimi i turizmit me sektore të tjerë të ekonomisë.

## 3. Projektet kryesore të PBA-së 2019-2021

### 3.1 Paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit

Burimi i informacionit: Fishat e projekteve të PPV/PZhS

Bashkëngjitur Aneksi 1 – Projektet kryesore të Investimeve kapitale të PBA-së 2019-2021 të lidhura me PPV.

### 3.2 Plani i shpenzimeve kapitale /projektplani 2019-2021

Bashkëngjitur – Shpenzimet kapitale 2016-2021 ( F15 – sheet i FPT).

Marrë nga Instrumenti i Planifikimit Financiar, [F15]

Informacion shtesë: [C1b]; [F2], [F6], [F16]

## 4. Informacion financiar

### 4.1 Supozimet e planifikimit

Tabela D2 jep llogaritjet makroekonomike për të cilat kemi informacion vetëm kursin e kembimit valutor që është dhënë në udhëzimin plotësues 6/1 datë 28.12.2018 “ Per buxhetin vendor” .Kjo tabelë nuk ndikon në produktet e tabelave të FPT.